



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

BURSA STUDIMI NË HUNGARI, VITI AKADEMIK 2016-2017

Në zbatim të programit të bashkëpunimit me Hungarinë në fushën e arsimit dhe shkencës, Qeveria e Republikës së Hungarisë, përmes Zyrës së Bordit të Bursave Hungareze pranë Institucionit të Arsimit të Lartë "Balassi", shpall programin e bursave shtetërore për shtetasit e huaj për vitin akademik 2016-2017. Programi i bursave përfshin: vizitat studimore, kurset verore dhe studime të plota/të pjesshme universitare, pasuniversitare, në fushën e kërkimit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë ose të Kërkimit të Hungarisë, sipas kategorive në vijim:

A- Studime të pjesshme në nivelin Bachelor dhe Master (3-10 muaj); Për këto bursa mund të aplikojnë studentë për programe të ndryshme studimi në Bachelor (BA) ose Master Shkencor (BSc). Për llojin A preferohen ata kandidatë që studiojnë ose punojnë në fushën e gjuhës dhe të letërsisë hungareze, ose studentë të regjistruar në programet e studimit: mjekësi e përgjithshme, stomatologji, farmakologji, veterinari, arkitekturë dhe drejtësi. Kandidatët e interesuar duhet të kenë përfunduar të paktën 2 semestra në institucionet e arsimit të lartë të vendit të tyre. Moshë e rekomanduar është deri në 30 vjeç.

B - Studime pasuniversitare ose në fushën e kërkimit (3-21 ditë ose 1-10 muaj); Për këtë kategori burse të gjithë të interesuarit duhet të jenë të pajisur me një diplomë të nivelit Master. Rekomandohen aplikantët, të cilët dëshirojnë të kryejnë kërkime për tezën e studimit në PhD. Por këta kandidatë duhet të jenë në vazhdim të studimeve në programin e doktoraturës. Aplikantët, të cilët përfshihen në këtë nivel studimi, nuk përfitojnë kredite. Moshë e rekomanduar është deri në 40 vjeç.

C/1: Studime në Doktorature (PHD,) program i plotë (36 muaj); Për këtë nivel mund të aplikojnë kandidatë që zotërojnë gjuhën Hungareze ose kandidatë që janë të pajisur me certifikatën e njohjes së gjuhës tjetër përkatëse të përcaktuar nga Zyra e Bordit të Bursave Hungareze për kryerjen e studimeve, nëse gjuha e punës nuk është Hungarishtja. Institucioni pritës duhet ta deklarojë këtë fakt në ftesën drejtuar aplikantit. Bursa jepet me kusht për ata kandidatë që i nënshtrohen provimit para pranimit në universitet për programin PhD. Moshë e rekomanduar është deri në 35 vjeç.

C/2: Studime në Doktorature (PHD, program i pjesshëm 1-12 muaj); Për këtë program mund të aplikojnë vetëm ata studentë që janë të regjistruar në doktoraturë në universitetet e akredituara të vendit të tyre, ose të një vendi tjetër të huaj, por jo në Hungari. Aplikantët nuk duhet të kenë kaluar moshën 35 vjeç.

D: Studime në postdoktoraturë dhe në fushën e kërkimit (1-10 muaj). Aplikantët duhet të kenë titullin Doktor ose një gradë të barasvlershme. Mosha e rekomanduar është deri më 45 vjeç.

E: Vizita Kërkimore (3-21 ditë, ose 1-10 muaj). Aplikantët duhet të jenë asistentë profesorë, profesorë ose kërkues të nivelit të lartë dhe të kenë minimalisht titullin “Doktor i Shkencave”. Nuk ka kufizim moshe.

F: Kurse Vere (1-4 javë). Aplikantët do të marrin pjesë me bursë vetëm në një kurset e publikuara në listën ‘Summer Courses 2016’ të rrjetit HSB (Hungarian scholarship Board, HSB website), e cila gjendet në faqen www.scholarship.hu.

Për vizitat kërkimore (E) dhe kurset e verës (F) nuk ka kufizim moshe.

Aplikantët, përmes aplikimit ONLINE të rrjetit HSB, duhet të bëjnë regjistrimin në website-in e Bordit Hungarez të Bursave (Hungarian scholarship Board, HSB website).

Gjuha e punës për kryerjen e studimeve (i përcaktuar paraprakisht nga universiteti përkatës) do të jetë një nga 4 gjuhët në vijim:

1. Gjuha hungareze;
2. Gjuha angleze;
3. Gjuha franceze;
4. Gjuha Gjermane.

Gjatë procesit të aplikimit, aplikantët duhet të shkarkojnë dokumentet e skanuara, në vijim:

A- Për programet e studimit të nivelit bachelor, të pjesëshme:

1. Formularin e aplikimit me fotografi të Bordit Hungarez të Bursave, i cili plotësohet online. Aplikantët duhet të shkarkojnë dokumentet përmes rrjetit HSB (Hungarian scholarship Board, HSB website);
2. Një CV që përmban informacion për ciklet e shkollimit dhe adresat e shkollave ku aplikanti ka studiuar;
3. Letrën e interesit;
4. Kopjen e noterizuar të listës së notave për dy semestra gjatë vitit të parë akademik të institucionit të vendit të origjinës së aplikantit;
5. Certifikatën e njohjes së gjuhës hungareze që kërkohet për kryerjen e kursit/ të programit studimit të përcaktuar paraprakisht. Institucioni pritës duhet ta deklarojë këtë fakt në ftesën drejtuar aplikantit;
6. Kopjen e letrës së regjistrimit të lëshuar nga institucioni i vendi origjinës së aplikantit;
7. Fotokopjen e faqes së pasaportës;
8. Raportin mjekësor për aftësi studimi.

B- Për studime pasuniversitare/ kërkimore:

1. Formularin e aplikimit me fotografi të Bordit Hungarez të Bursave, i cili plotësohet online. Aplikantët duhet të shkarkojnë dokumentet përmes rrjetit HSB (Hungarian scholarship Board, HSB website);

2. Një CV që përmban informacion për ciklet e shkollimit dhe adresat e shkollave ku aplikanti ka studiuar;
3. Një plan projekt të detajuar për fushën e studimit;
4. Kopjen e noterizuar të diplomës Master/ Master i shkencave ose të ndonjë dokumenti të ngjashëm që vërteton mbarimin e programit të studimit të nivelit I të studimeve të larta (bachelor);
5. Certifikatën e njohjes së gjuhës që kërkohet për kryerjen së studimit kërkimor të përcaktuar paraprakisht. Institucioni pritës duhet ta deklarojë këtë fakt në ftesën drejtuar aplikantit;
6. Listën e publikimeve;
7. Ftesën e Institucionit të arsimit të lartë, ose të ndonjë institucioni tjetër kërkimor hungarez, në të cilin është pranuar aplikanti;
8. Dy letra rekomandimi nga profesorë të institucioneve akademike/ kërkimore;
9. Raportin mjekësor për aftësi studimi.

Për studime të plota (C1)/ të pjesëshme (C2) në doktoraturë/ postdoktoraturë/ në fushën e kërkimit (D)/ vizita pune (E)/ kurse vere (F):

1. Formularin e aplikimit me fotografi të Bordit Hungarez të Bursave, i cili plotësohet online. Aplikantët duhet të shkarkojnë dokumentet përmes rrjetit HSB (Hungarian scholarship Board).
2. Një CV që përmban informacion për ciklet e shkollimit dhe adresat e shkollave ku aplikanti ka studiuar;
3. Një plan projekt të detajuar për fushën e studimit;
4. Kopjen e noterizuar të diplomës ose të ndonjë dokumenti tjetër të ngjashëm që vërteton mbarimin e programit të studimit të nivelit master/ master i shkencave.
5. Për pjesëmarrje në kursin e verës, kopjen e noterizuar të diplomës ose të ndonjë dokumenti të ngjashëm që vërteton mbarimin e programit të studimit të nivelit më të fundit. Afati i fundit për aplikim është data 30 qershor 2016;
6. Certifikatën e njohjes së gjuhës që kërkohet për kryerjen së studimit të përcaktuar paraprakisht. Institucioni pritës duhet ta deklarojë këtë fakt në ftesës drejtuar aplikantit;
7. Listën e botimeve të artikujve të ndryshëm;
8. Ftesën e Institucionit të arsimit të lartë, ose të institucionit kërkimor hungarez, në të cilin është pranuar aplikanti;
9. Dy letra rekomandimi nga profesorë të institucioneve akademike;
10. Raportin mjekësor për aftësi studimi.

Sugjerohet që të gjithë aplikantët duhet të kenë edhe kopjen e tyre origjinale të dokumentacionit.

Afatet e fundit për dorëzimin e aplikimeve për këto bursa, sipas kategorive në vijim, janë datat:

1. 16 November, 2015 për vizitat studimore;
2. 15 Janar 2016 për kurset e verës;
3. 29 shkurt 2016 për studime të pjesëshme universitare/ pasuniversitare ;

Për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit referojuni materialeve informativë që gjenden në adresat web-site:

www.scholarship.hu;

<http://www.scholarship.hu/Englishsite/Asemesterpartialstudies/tabid/186/language/en-US/Default.aspx>

<http://www.scholarship.hu/LinkClick.aspx?fileticket=7181-1WhCQY%3d&tabid=218&language=hu-HU>;

2 (dy) kopje origjinale të dokumentacionit si dhe formulari i aplikimit (kopje e printuar) në gjuhë hungareze ose të përkthyer në një nga gjuhët: angleze, franceze, ose Gjermane, duhet të përcillen gjithashtu me postë, njëkohësisht, krahas aplikimit online, në adresën e poshtëshënuar:

Balassi Intézet, MÖB Iroda

1519 Budapest, Pf. 385

Hungary

Phone: +36 1 384 9009

Fax: +36 1 343 6489

DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE